



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 722/2017**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.11.2017 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bolv Oil” sha për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur* me Nr. REF-25546-09-05-2017, me objekt: “*Blerje Karburant Diesel 0.1% për ngrohje dhe shpërndarje në objektet shkollore dhe parashkollore*”, me fond limit 30 470 204 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.

**Ankimues:**

“A&T” sha  
Adresa: Rruga: “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 7/3 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit  
Adresa: Rruga “5 Maji”, Godina 17 pranë tregut të Medresesë Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.09.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-25546-09-05-2017, me objekt: “Blerje Karburant Diesel 0.1% për ngrohje dhe shpërndarje në objektet shkollore dhe parashkollore”, me fond limit 30 470 204 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 29.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.

II.2 . Në datën 29.09.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 05.10.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “AZ Distribution”	pa ofertë ekonomike	
2. “RESULI - ER”	pa ofertë ekonomike	
3. “EUROPETROL DURRES ALBANIA”	pa ofertë ekonomike	
4. “AL-NOBEL”	pa ofertë ekonomike	
5. “EROIL” shpk	me marzh fitimi 9.7 %	skualifikuar
6. “KASTRATI” sha	me marzh fitimi 13.7 %	skualifikuar
7. “Bolv Oil” sha	me marzh fitimi 18.2 %	kualifikuar
8. “A&T” sha	me marzh fitimi 23.8 %	kualifikuar

II.4. Në datën 11.10.2017 operatori ekonomik “A&T” sha kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:

[...]

*Referuar klasifikimit të mësipërm të bërë nga autoriteti kontraktor me këtë klasifikim nga ana e KVO-së vlerësuam si të padrejtë psi shoqëria “Bolv Oil” sha nuk i plotëson të gjitha kërksat për kualifikim dhe për këtë iu drejtuam me ankesë AK-së duke shprehur argumentat si më poshtë vijon:*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur fletë analizë për produktin Diesel 01% sipas gërmës b të Kapacitetit Teknik të DST-ve.*

*Shoqëria Bolv Oil” sha nuk disponon autobot me sasi 1000 litra sipas gërmës i kapaciteti teknik të DST-ve*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur dokument për akreditimin certifikatave ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004 sipas gërmës f të kapacitetit teknik të DST-ve*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur vërtetim nga OSHEE për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet.*

II.5. Autoriteti kontraktor në datën 12.10.2017 me anë të shkresës nr.1805/4 datë 12.10.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke mos pranuar ankesën e operatorit ekonomik.

II.6. Në datën 17.10.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë vijon:

[...]

*Referuar klasifikimit të mësipërm të bërë nga autoriteti kontraktor me këtë klasifikim nga ana e KVO-së vlerësuam si të padrejtë pasi shoqëria “Bolv Oil” sha nuk i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim dhe për këtë iu drejtuam me ankesë AK-së duke shprehur argumentat si më poshtë vijon:*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur fletë analizë për produktin Diesel 01% sipas gërmës b të Kapacitetit Teknik të DST-ve.*

*Shoqëria Bolv Oil” sha nuk disponon autobot me sasi 1000 litra sipas gërmës i kapaciteti teknik të DST-ve*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur dokument për akreditimin certifikatave ISO 9001:2008 dhe ISO 14001:2004 sipas gërmës f të kapacitetit teknik të DST-ve*

*Shoqëria “Bolv Oil” sha nuk ka paraqitur vërtetim nga OSHEE për shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet.*

*Në datën 16.10.2017 në përgjigjetë ankesës tonë me shkresën nr. 1805/4prot., datë 12.10.2017, AK-ja Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, na bën me dije se nuk pranon ankimin tonë duke arsyetuar:*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga OE të vëna në dispozicion nga KVO konstatojmë se “Bolv Oil” sha ka paraqitur fletë nalizën e produktit të ofruar të llëshuar nga ISHTI me numër 3783/1prot datë 06.09.2017.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga oe të vëna në dispozicion nga KVO konstatojmë se oe “Bolv Oil” sha ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm për autobotin me targë FR 0402 Dnë pronësi të oe “Bolv Oil” sha me kapacitet 2000lt ku në të dhënat teknike të tij të konfirmuara nga DPM me Pasaportën e Mjetit me nr. Serial 000496 rezulton se autoboti është i përbërë nga dy dhoma me nga 1000 lt secila dhe posedon kontaliter naftë të certifikuar nga ky institucion me certifikatën e Verifikimit Nr. LV. -0317K048. Gjithashtu oe “Bolv Oil” sha ka paraqitur një deklaratë furnizimi ku deklaron se mund të furnizojë objektet shkollore dhe parashkollore në sasi 100lt dhe 2000lt. Me këtë përgjigje AK-ja pranon se “Bolv Oil” sha nuk disponon mjetin e transportit autobot me kapacitet 500lt deri në 1000lt të përcaktuara qartë në gërmën i Kapaciteti Teknik në dst. Për më tepër AK-ja ka qënë shumë e qartë në dst për arsyen përse kërkon autobotin me këtë kapacitet “Për arsyen e vendodhjes të kaldajave në objekte ku është tepër e vështirë furnizimi me mjete të tonazhit të rëndë oe duhet të disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën një mjet transporti autobot me kapacitet 500lt deri në 1000lt...” Pra AK-ja ka kualifikuar “Bolv Oil” sha në kundërshtim me LPP-në dhe RRPP-në.*

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga oe të vëna në dispozicion nga KVO-ja konstatojmë se oe “Bolv Oil” sha ka paraqitur të gjitha certifikatat ISO të kërkuara nga AK-jatë njehsuara me orgjinalin dhe të përkthyer dhe të noterizuara të llëshuara nga enti certifikues TV NORD GMBH. Përsa më sipër ju informojmë se në certifikatat ISO të paraqitura nga oe janë të certifikuara nga Trupa Gjermane e Akreditimit (DAKKS) lehtësisht e dukshme në certifikatat e paraqitura. Kjo trupë akreditimi është anëtare firmosëse e marrëveshjes ndërkombëtare të IAF EA (European Accreditation), ILAC në fushën e certifikimit të sistemeve të menaxhimit ku Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) është anëtare me të drejta të plota dhe në bazë të nenit 13 pika 3 të ligjit 1162014 datë 09.11.2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në RSH”, njeh dhe certifikatat e certifikimit të llëshuara nga trupa certifikuese të akredituara nga DAKKS ku përfshihet dhe enti certifikues TUV NORD GMBH.*

*Me këtë përgjigje K-ja pranon se oe “Bolv Oil” sha nuk ka dorëzuar certifikata ISO të llëshuara nga ent certifikues i njohur nga DPA ose nga ente certifikuese të huaja ku për të vërtetuar këtë oe duhet të paraqesë dokumentin e akreditimit në orgjinal ose të njehësuar me orgjinalin gërma f të kapacitetit teknik i DST-ve. Nga Kjo përgjigje rezulton se mungon dokumenti i akreditimit dhe për rrjedhojë nuk mund të quhen të vlefshme certifikatat ISO e dorëzuara në këtë procedurë prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në mënyrë elektronike nga oe të vëna në dispozicion nga KVO –ja konstatojmë se oe “Bolv Oil” sha ka paraqitur vërtetim debie nga OSHEE me nr. 21713/1 datë 28.09.2017 ku rezulton të ketë zero (0) lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike.*

Në këtë përgjigje AK-ja nuk sqaron ankesën tonë duke mos përcaktuar nëse oe ka shlyer të gjitha deyrimet e maturuara të energjisë elektrike për të gjitha vendet ku rezulton të jetë i regjistruar e përcaktuar qartë në DST. Sa më sipër konstatojmë se AK-ja Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, në përgjigjen e saj qëllimisht është munduar të interpretojë në mënyrë të gabuar kriteret për kualifikim të publikuara në DST. Kriteret e publikuara në DST janë të qarta dhe nuk lënë vend për keqinterpretime. Duke qënë se shoqëria “Bolv Oil” sha nuk plotëson kriteret për kualifikim të publikuara në DST kërkojmë nga KPP-ja të skualifikojë shoqërinë “Bolv Oil” sha nga kjo procedurë prokurimi.[...]

II.7. Në datën 30.10.2017 me anë të shkresës nr.1873/1prot datë 26.10.2017, protokolluar me tonën nr. 1597/2 prot., datë 30.10.2017, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 30.10.2017 me anë të shkresës nr.1884prot. datë 26.10.2017, protokolluar me tonën nr. 1597/3 datë 30.10.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar “kërkesë për përshpejtim procedure” pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e palës ankimuese “A&T” sha mbi kualifikimin e ofertës operatorit ekonomik “Bolv Oil” sha me argumentin se “[...]Shoqëria Bolv Oil” sha nuk disponon autobot me sasi 1000 litra sipas gërmës i kapaciteti teknik të DST-ve. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se :

III.1.1. Në Shtojcën 8 “Kriteret Veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” gërma (i) të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar: “

*Per arsyen e vendodhjes te kaldajave në objekte ku është tepër e vështirë furnizimi me mjete të tonazhit të rëndë, Operatori Ekonomik duhet te disponojë në pronësi të vet ose me qira të paktën 1 (një) mjet transporti autobot me kapacitet nga 500 litra deri në 1000 litra dhe 1(një) mjet autobot me kapacitet deri në 5000 lt. Për të provuar disponimin e tyre (në pronësi) shoqëria duhet te dorëzojë librezën e qarkullimit, çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit. Autobotet duhet te jene te rregjistruar ne Ekstraktin e Q.K.R-se se Operatorit Ekonomik. Per mjetet e siguruar me qera Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentin qe vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet te shoqërohet me kontratën përkatëse te qirase/ furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontratës, objekt i këtij prokurimi.*



III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.1.2.1. Në nenin 46, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“ [...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit[...].”*

III.1.2.2. Në nenin 27 “Kontrata e Mallrave” pika 3 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se :

*“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, ( S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm operatori ekonomik ankimues “Bolv Oil” sha ka dorëzuar:

- i. Leje qarkullim i mjeti me targë FR0402D (në pronësi) me kapacitet*
- ii. certifikatën e kontrollit teknik të mjetit me targë FR0402D (në pronësi) me kapacitet*
- iii. siguracionin e mjetit të mjetit me targë FR042D (në pronësi) me kapacitet*

III.1.4. Autoriteti kontraktor në lidhje me përcaktimin e këtij kriteri, argumenton se ky kriter është përcaktuar pikërisht me këtë kapacitet mbajtës për arsyen e vendndodhjes të kaldajave në objekte ku është i vështirë furnizimi me mjete të tonazhit të rëndë. Pra, autoriteti kontraktor ka një arsye dhe një argument se pse ka përcaktuar një kriter të tillë duke vendosur limite nga një tonazh minimum deri në një tonazh maksimum, kusht ky që duhet të plotësohet nga operatorët ekonomikë të interesuar pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

III.1.5. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Bolv Oil” sha nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e *“1 (një) mjeti transporti autobot me kapacitet nga 500 litra deri në 1000 litra”*

Konstatohet se, mjeti i transportit autobot me targë FR042D (në pronësi), i deklaruar nga operatori ekonomik si autobot, për të cilën ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit , nuk plotëson kapacitetin mbajtës *500 litra deri në 1000 litra*. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetin. Kapaciteti real mbajtës i mjetit është një element që jepet më së miri në të dhënat e lejes së qarkullimit të mjetit, dhe konkretisht mjeti në fjalë i paraqitur nga operatori ekonomik është me kapacitet 1720kg. Sqarojmë se, kriteri për mjetet i vendosur nga autoriteti

kontraktor si më poshtë citoj: “[...]Pwr arsye e vendodhjes tw kaldajave në objekte ku është tepër e vështirë furnizimi me mjete të tonazhit të rëndë[...]”, duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të pretendohet nga operatori ekonomik se ka paraqitur dokumentacion për kapacitetin e mjetit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet kapaciteti i kërkuar i mjetit sipas tonazhit përkatës, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit (kapacitet mbajtës 500 litra deri në 1000 litra, siguracion, leje qarkullimi etj). Sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Bolv – Oil” sh.a., ku qartësisht verifikohen të dhënat e mjetit dhe konkretisht edhe kapaciteti mbajtës i mjetit të deklaruar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ky operator nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi është në tejkalim të kapacitetit mbajtës të mjetit me limite nga 500-1000 lt.

Operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike ka dorëzuar edhe dokumentin “Deklaratë Furnizimi”, në të cilën deklaroi se: “[...]Shoqëria “Blov-Oil” sha deklaroi se autoboti me targë FR0402D me kapacitet maksimal 2000 litra është i pajisur me kontaliter të certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Klibrimit dhe Metrologjisë dhe mund të furnizojë objektet shkollorë dhe parashkollorë me sasi nga 100 litra deri në 2000 litra ose sipas kërkesave të AK-së[...]”, duke konfirmuar dhe pranuar faktin se mjete i paraqitur prej tij, në përmbushje të kriterit për mjetin me kapacitet 500-1000lt, është me kapacitet maksimal 2000lt, duke tejkaluar dukshëm kushtin e vendosur nga autoriteti kontraktor deri në 1000 lt.

Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me faktin që autoriteti kontraktor ka kërkuar shpjegime shtesë në lidhje me ofertën e operatorit ekonomik “Bolv – Oil” sh.a., vlerëson gjithashtu se autoriteti kontraktor nuk ka qenë në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pasi dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Bolv – Oil” sh.a. është i qartë dhe i lexueshëm në të gjitha të dhënat që përmban leja e qarkullimit të mjetit.. Operatori ekonomik duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë.

III.1.6. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Akoma më tej, sqarojmë se në rast se operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

III.1.8. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.9. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Bolv Oil” sha nuk përmbush kriteret dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “A&T” sh.a. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “A&T” sha mbi kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “Bolv Oil” sha, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Bolv – Oil” sh.a. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.



Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,


### Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A&T” sha për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-25546-09-05-2017, me objekt: “Blerje Karburant Diesel 0.1% për ngrohje dhe shpërndarje në objektet shkollore dhe parashkollore”, me fond limit 30 470 204 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 29.09.2017, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Bolv Oil” sha dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A&T” sha.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1597 Protokolli;**

**Datë 17.10.2017**



### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

**Kryetar**

**Evis Shurdha**